



**ËSHTË RAMAZAN,
ËSHTË NDRYSHE,
ËSHTË NATË KADRI!**



**BAJRAMI I RAMAZANIT MES
SË KALUARËS DHE TRENDEVE
TË REJA NDËR SHQIPTARË**



**SIKUR TË DISH
TA VLERËSOSH BAJRAMIN!...**

UDHA ISLAME

Viti 21 - Nr. 4 (242), Prill, 2023

www.myftinia-shkoder.org

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative



MYFTINIASHKODER1990

Është Ramazan, është dritë, është Shkodër!

*"Fytyra të qeshura. Zëra fëmijësh në gëzim.
Të rinj që kanë bisedat e moshës...
Aty-këtu, dëgjohen zërat e nënave dhe vajzave të
xhamisë, pastërtoret që kujdesen për Shtëpinë e
Allahut, që të shndrisi e të vezullojë nga pastërtia
dhe rendi.*

*Hyn me bismilah dhe e shijon çdo selam me
krejt të pranishmit buzagaz! Është Ramazan!"*



**MYFTIU I SHKODRËS LIGJËRON NË QENDRËN
ISLAME KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI**



(f. 15)

**MYFTINIA SHKODËR DHE "JETIMËT E BALLKANIT"
PRANË NJERËZVE NË NEVOJË ME 500 PAKO USHQIMORE**



(f. 15)



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Megjithëse atë që institucioni i Bashkisë Shkodër duhej të bënte për Ramazan, nuk e bëri asnjëherë në këto 33 vite, patjetër që zbulurimi i vetë institucionit të Bashkisë sivjet (për festë, se fjalën Ramazan, kushedi nuk ia ka shkruar dora adminit) dhe ato pak vargje dritash të vendosura aty përballë, meritojnë vlerësim dhe janë një shembull, që ia kalon edhe Tiranës pragmatiste!

Çështja nuk është për dy a dhjetë vargje dritash, jo! Është përtej! Është te ekuilibrat, te normat, te standardet, që tek ne nuk u vunë kurrë!

Erdhi koha, që ne, vendi musliman më i madh në Evropë, të na imponohet nga sjelljet anormale të dy tarafave të politikës së këtyre 3 dekadave të fundit, një lloj kompleksiteti në raport me fenë tonë, shfaqjen e saj haptas dhe dëshminë e identitetit pa pasur ndrojtjen e reaksioneve! Hajr, përse?

Për hatrin e kujt, a për borxh të kujt, xhanëm?!

Nga ana tjetër, elhamdulillah, që po bëhemi dëshmitarë të një kohe të paralajmëruar në fjalët e të Dërguarit (a.s), që zbulurimet e shesheve për Ramazan po na i mëson Londra, faljet publike (për të cilat nuk kemi nevojë, se shqyq Zotit kemi plot xhami!) po i shohim në zemër të Nju Jorkut, frekuentimin më të madh të institucioneve fetare nga rinia, atë të muslimanëve, po na e dëshmon Franca, ndalimin e ndeshjeve të futbollit për iftarin e shpejtë të futbollistëve muslimanë, po e tregon Premier League e Anglisë, senatorët dhe deputetet muslimane me shami, djepi i demokracisë, ShBA, kandidimin për antare të këshillit bashkiak të muslimaneve me shami, bashkitë e Italisë, por jo vetëm.

Kështu që, të shkruajmë e të stërshkruajmë sot për zbulurimin e Shkodrës, djepit të Islamit, historisë së tolerancës, hoxhallarëve, medreseve, etj., me drita e fenerë Ramazani nga taksat e vetë muslimanëve, është dëshmi regresi dhe njollë turpi në hak të historisë sonë, tabanit dhe qytetarisë!

Dhe, kush ka hallin e fushatës, jua kam falur fushatat dhe partitë, hallin tuaj mos e pastë njeri!

Unë shkruaj dhe thërras për diçka

mbi fushatat tuaja, partitë dhe politikën! Unë nuk bëj politikë, të nderuar, jua kam thënë edhe më herët; se po ta bëja, ju garantoj se ju do shifshi e do dëgjoshi ç'ka nuk ju gëzon, as ju lë rehat!

Prandaj, Bashkisë aktuale, faleminderit për kaq, ndërsa asaj që del pas 14 majit (Allahumme, veç mirë e më mirë për këtë qytet dhe të ardhmen e tij!), i duhet të bëjë një tobe të madhe publike me muslimanët e këtij qyteti, me lagjet e tyre, me investimet në to, por

PRANDAJ, BASHKISË AKTUALE, FALEMINDERIT PËR KAQ, NDËRSA ASAJ QË DEL PAS 14 MAJIT (ALLAHUMME, VEÇ MIRË E MË MIRË PËR KËTË QYTET DHE TË ARDHMEN E TIJ!), I DUHET TË BËJË NJË TOBE TË MADHE PUBLIKE ME MUSLIMANËT E KËTJË QYTETI, ME LAGJET E TYRE, ME INVESTIMET NË TO, POR JO VETËM; ME VEPRA, PËRTEJ FJALËVE, QË DERI MË SOT, KANË QENË KRYESISHT SPROVË E DINJITETIT; PËR DIKË I RUAJTUR DHE PËR DIKË TJETËR, I HUMBUR DHE I DALË BOJE..!?

jo vetëm; me vepra, përtej fjalëve, që deri më sot, kanë qenë kryesisht sprovë e dinjitetit; për dikë i ruajtur dhe për dikë tjetër, i humbur dhe i dalë boje..!?

Allahu ju dashtë!

Shkodër, më 12 prill 2023

ËSHTË RAMAZAN, ËSHTË NDRYSHE, ËSHTË NATË KADRI!

Nuk ka si mexhliset e Ramazani! Na bashkon një frymë, që na lartëson në pozitë e rimëkëmbjes, duke parë veten në pasqyrat e historisë, trashëgimisë dhe krenarisë legjitime!

Mbrëmë, xhamia e fshatit Bardhaj ishte e mbushur me dritë e gëzim. Pas iftarit të madh, që imami me këshillin e xhamisë kishin organizuar, ku të gjithë ishin angazhuar nga pak, për ta kthyer atë mbrëmje në një natë, si ato të gëzimeve të mëdha familjare, tash ishte koha e namazit të jacisë, teravisë dhe lutjeve të Natës së Kadrit.

Është e fortë si ndjesi, ajo që

“NË MOMENTIN QË FËMIJËT DHE RINIA PARAPRIJNË DREJT XHAMISË, ËSHTË SHENJË ZGJIMI, ËSHTË DËSHMI RIMËKËMBJEJE, ËSHTË PREKJE E HOLLË E RIPËRTËRITJES SË AMANETIT TË ATYRE QË KALUAN DHE BREZAVE QË SHKUAN, PREJ ATYRE QË E PËRQAFUAN ME ZEMËR E SHPIRT KËTË FË TË PASTËR ISLAME DHE UDHËZIMIN E ZOTIT NË JETË!”

përshfaqet në horizontet e kësaj vizite, që përtej urës së fshatit, shfaq hiet e veta me minaren e bardhë, të zbuluar me dritë e zâ, që përhap gjithandej lutje e bekime kur'anore, si mantel paqeje e mëshirë mbi krejt fshatin... Pastaj afrohesha dhe, pamja e parë që të zënë sytë janë të rinjtë dhe fëmijët, që i paraprijnë gjyshërve dhe baballarëve për të ardhur në xhami...

Në fakt, në momentin që fëmijët dhe rinia paraprijnë drejt xhamisë, është shenjë zgjimi, është dëshmi rimëkëmbjeje, është prekje e hollë e ripërtëritjes së amanetit të atyre që kaluan dhe brezave që shkuan, prej atyre

MESAZHI I MYFTIUT, IMAM MUHAMED B. SYTARI, ME RASTIN E FITËR BAJRAMIT 1444/2023

*Të dashur dhe të shtrenjtë
motra dhe vëllezër besimtarë,*

Në atmosferën e begatë të Fitër Bajramit më lejoni t'ju përhapoj me zemër duke u lutur që Allahu i Madhëruar t'i ketë pranuar agjërimin, adhurimet, veprat e mira, nga gjithë secili prej jush.

Një muaj i begatë në të cilin përjetuam bashkërisht një mirësi shumë të madhe dhe u bëmë dëshmitarë të një Ramazani historik për të gjithë ne; Ramazan, në të cilin dëshmuam paralajmërimet e mëdha të pejgamberit tonë (a.s), që thoshte: “Do të mbërrijë kjo fe ku ka mbërritur nata dhe dita.”

U bëmë dëshmitarë të leximit të Kur'anit, të faljes së namazit në zemër të shesheve të Nju-Jorkut;

U bëmë dëshmitarë të iftareve në zemër të Kembrixhit e në stadiumet më të mëdha të Evropës;

U bëmë dëshmitarë të leximit të Kur'anit dhe këndimit të ezanit në xhamitë e Amerikës dhe gjithandej në Perëndim;

U bëmë dëshmitarë të përhapjes të një fryme të madhe e të mrekullueshme të paqes, të mirëkuptimit, harmonisë, vëllazërisë, bamirësisë dhe të solidaritetit me njerëzit pa dallim anëmbanë botës;

U bëmë dëshmitarë se si Zoti i gjithësisë e mbron këtë fe të madhërueshme islame dhe se si ky Islam u kthye në fenë e shekullit për krejt njerëzit;



U bëmë dëshmitarë se si thirrja e mëshirës, thirrja e Hz. Muhammedit (a.s) në këtë Ramazan u përhap gjithandej anëmbanë botës, duke dëshmuar gjithësia për pastërtinë e Islamit, për bukurinë e Islamit, për madhësinë e Islamit dhe për t'u parë tek muslimanët agjërimi i tyre, komunikimi, mirësjellja, morali i tyre.

Ajo çfarë në të vërtetë na thërret drejt saj Zoti i gjithësisë është mëshira dhe përhapja e paqes me krejt njerëzit pa dallim kudo që të jemi dhe me këdo që të jemi.

*Të dashur dhe të shtrenjtë
motra dhe vëllezër besimtarë!*

Ky Islam është feja e këtij shekulli dhe ne jemi dëshmitarë të të mëdhenj dhe më të mirë të kësaj mirësie hyjnore. Kemi qëlluar në këtë kohë dhe jemi ftuar nga Zoti i gjithësisë për ta përhapur këtë dritë, për ta përhapur këtë mirësi. Ne shqiptarët na ka veçuar Zoti i gjithësisë në krejt banorët e këtij rajoni, me

përqaftimin e Islamit, shekuj e shekuj më përpara.

Ne shqiptarët na ka veçuar Zoti i gjithësisë duke u bërë mbrojtësit e këtij Islami edhe në kohët më të errëta të historisë tonë kombëtare. Ne shqiptarët na ka veçuar Zoti i gjithësisë për t'u bërë përçuesit e këtij Islami të pastër edhe në kohët më të vështira të historisë tonë. Prandaj me zemër të mirë këtë mirësi dhe këtë mëshirë të pakufishme të Zotit të Gjithësisë.

Me zemër të mirë Fitër Bajramin.

Me zemër të mirë çdo moment në të cilin ne përpiqemi dhe rrugëtojmë dorë për dorë drejt dritës së Zotit dhe bekimeve të Tij.

Përhapeni gëzimin gjithandej. Përhapeni mirësinë e Islamit gjithandej.

Përhapeni fjalën e Zotit gjithandej me këdo, me të afërmit, me familjarët, me komshinjtë, me fafësin e me këdo tjetër.

Allahu ju dashtë dhe me zemër të mirë Fitër Bajramin!

2

që e përqaftuan me zemër e shpirt këtë fë të pastër islame dhe udhëzimin e Zotit në jetë!

Fytyra të qeshura. Zëra fëmijësh në gëzim. Të rinj që kanë bisedat e moshës. Pak më tutje, Haxhi Ahmeti, plaku i mirë, që përveç zemrës së madhe që ka, di të të falë lutje e bekime, si dëshmi e shpirtit të madh të krejt kësaj zone besimtare! Aty-këtu, dëgjohen zërat e nënave dhe vajzave të xhamisë, pastërtoret që kujdesen për Shtëpinë e Allahut, që të shndrisi e të vezullojë nga pastërtia dhe rendi. Hyn me bismilal dhe e shijon çdo selam me krejt të pranishmit buzagaz!

Është Ramazan. Është Natë Kadri. Është mundësi e re, natë e re, me të cilën

nis një ditë e re, rrethuar me bekime e mëshirë, selame melekësh, që turma-turma zbresin nga lartësitë qiellore për të takuar besimtarët, që horizonteve vërshojnë për të mbushur shpirtin në shtëpitë e Zotit, ku ka vend për të gjithë...

Një fije e hollë e ndan euforinë, shfaqjet emocionale dhe përshkrimet poetikisht korrekte, nga vullneti real për të ndërruar stilin e të menduarit, atë të lexuarit, të vepruarit dhe të sjellurit sipas frymës së vërtetë të këtij Muaji!

Është Ramazan. Është ndryshe. Realisht, është ndryshe! Me lutje e përgjërime, namaze e adhurime, ilahi e kujtime, këshilla e këmbim bisedash të denja për mexhlise Ramazani, kjo Natë

mbeti dëshmi Nate Kadri...

Bashkë me imamin e xhamisë; hoxhën, mjekun, infermierin, vëllanë e madh, kujdestarin e të kudogjendurin në gëzimet dhe hidhërimet e fahatit, me Senadin, shoqëruesin besnik, me Hakimin, që më ndjek në heshtje dhe është i vëmendshëm për çdo detaj, me Jasinin, që e ka një hise loje edhe në pushimin ndërmjet teravisë dhe namazit të tesbihëve, si dhe të rinjtë e djemtë e xhamisë, dalim të mbushur, pas ca orësh të kaluara në kijamin e Natës së Kadrit, me besim e shpresë!

Është Natë, dëshmi Nate Kadri..!

Shkodër, më 18 prill 2023

3



Evans Drishti

SIKUR TË DISH TA VLERËSOSH BAJRAMIN!...

*Nëse dita sot shpirtin ta rëndoi,
Mos u trishto, të them shpreso,
Kur një shi me lot qiellin ta mbulojë,
Mos u trishto, të them shpreso.*

*Lulja kokën ngre, kur një rreze del,
Dhe tek ajo shikon ditën që agon,
Ndez një diell brenda shpirtit shpresa,
Ti ringjallesh, jeto.*

Jetoje këtë ditë të veçantë tënden, të “ringjallesh” shpirtërisht dhe fizikisht!...

Ka njerëz që bëhen “të hijshëm” kur bëhen së bashku...

I keni parasysh ata njerëz që kuptohen edhe me një të vështruar në sy kur janë pranë njëri-tjetrit?... Të kuptojnë në buzëqeshje, në çdo kënaqësi...

Ku natyrshmëria dhe finesa shpirtërore i zënë vendin një respekti fals...

Janë ata, që të shfaqen si një kraharor i mbushur plot dashuri, një shpirt i dliër që të thonë se jemi së bashku, janë një mirëbesim, një mbështetje, një oqean...

Ka në këtë vend njerëz të atillë, që kur janë së bashku bëhen edhe më të hijshëm, me gjithë falsitetin, egoizmin apo meskinitetin që na shfaqet përherë...

Ata janë njerëz, që s’njohin ego, S’dinë të thonë “Unë!”...

Ata janë njerëz, që dinë të thonë vetëm “Ne!”...

A është një mundësi e mirë që festën e Bajramit ta vlerësojmë edhe në të tilla “gjetje”?...

Vlerësoje Bajramin, jo i zhytur në përgjumjen e një “dite pushimi”, por duke u betuar qoftë edhe një herë të vetme, të ngrihesh herët e të përfitosh nga vesa mëngjesore dhe mirësitë e një dite jo të zakonshme...

Përrjetoje Bajramin, duke u kujdesur për pastërtinë tënde shpirtërore e fizike, flokëkrehur, truplarë, duarartë, i veshur plot sqimë, trupkërpitur...

Ndije Bajramin me përqaftimin ndjesor të prindërve, të fëmijëve, të gruas, të burrit, të gjyshërve duke u shprehur kënaqësinë dhe dashurinë e sinqertë që ndjen për ta... S’duhet të bëhet e vështirë t’i thuash tjetrit se “e do dhe e respekton!”...

Shijoje Bajramin duke kundërmuar aromat e këndshme të luleve dhe kënaqësinë që të dhuron gjelbërimi dhe peizazhi natyror...Kur secili prej nesh të mbajë pastër ambientin që na rrethon, higjiena do jetë mbizotëruese kudo..

Mendoje Bajramin jo për të kolloftur që herët në mëngjes gjëra të ëmbla për të plotësuar unin dhe kënaqësinë e çastit, por duke pirë qoftë edhe një gotë ujë për ta shijuar atë ngopje që të

mundëson ta mbash veten në formë...

Gjykoje Bajramin duke u dhënë dorën njerëzve, jo si një gjest sipërfaqësor, si për të kaluar radhën apo si për të çuar në vend një “detyrim”, por të përçosh tek tjetri një energji pozitive dhe shpresëdhënëse...

Programoje Bajramin jo duke dërguar me telefon “shabllone” false si simbolikë të kësaj dite, por duke marrë mundimin t’u telefonosh dashamirësve, t’ua dëgjosh zërin, të shkëmbejë me ta tinguj valorë që të kthjellojnë mendjen dhe të ngrohin shpirtin...

Planifikoje Bajramin jo thjesht duke i hipur biçikletës apo makinës për të kryer ca vizita “kushtëzuese”, por duke trokitur me plot dashamirësi në dyert e komshinjve, të moshave të thyera, të fëmijëve jetimë... Tek të afërmit e cilitdo breznje qofshin duke u dhuruar buzëqeshje të ngrohtë dhe përzemërsi, duke ndarë me ta momente të këndshme dhe të paharrueshme...

Ideojë Bajramin duke vizituar njerëzit e dashur dhe të shtrenjtë jo për të ngopur stomakun me llojshmëri ëmbëlsirash, por për të shkëmbyer një

fjalë të ëmbël, një ndodhi të paqtë, një mesazh domethënës...

Shfrytëzoje Bajramin duke marrë mundimin të vizitosh edhe ata që s’janë më në këtë jetë. Të përjetosh të tjera ndjesi, sado të brishta qofshin ato...

Gjykoje Bajramin jo duke qëndruar “i bllokuar” në ekranin e telefonit pa kuptuar përsheptimin e minutave, por duke bërë një planifikim të mirëmenduar të kohës që ke në dispozicion, jo duke qëndruar i mpirë dhe pa lëvizur, por duke u kthjelluar për përgjegjësitë më minimale që të takojnë si krijesë e Zotit dhe si qytetar i këtij vendi të bekuar, jo duke pritur kohën të kalojë pa bërë asnjë përpjekje, por duke u munduar të zhvillosh veten së pari dhe të kontribuosh në çdo shërbim si brenda familjes ashtu edhe në shoqëri...

Plotësoje Bajramin duke i kushtuar një kohë të volitshme fëmijëve të tu. Të ndash me ta ato kënaqësi të pa përjetuara më parë. Të luash me ta, të argëtohesh, të qeshësh, të këndosh, të vallëzosh, të vraposh, të lexosh, të ecësh, të bashkëbisedosh, të bashkëpunosh, të ushqehesh, të diskutosh, të komunikosh me ta, por jo t’i qortosh, jo t’i keqtrajtoosh...

Kuptojë Bajramin si një mundësi për të shfletuar, lexuar e kuptuar një shkrim të pëlqyer, një gazetë apo revistë, një libër apo qoftë edhe një paragraf,... një ndodhi, një realitet, një dëshmi, një sfidë, një hap, një këndvështrim... Është një kohë e volitshme për t’u kthjelluar...

Vlerësoje Bajramin, si një ditë të ndryshme nga e djeshmja, e po aq e ndryshme edhe nga e nesërmja.

Vlerësoje Bajramin, si një mundësi e artë për të kuptuar se ç’peshë mbart emocioni që të dhuron festa...

Shpresëdhënëse vargjet e këngës “Të ndez një shpresë” e sjellë nga këngëtarja Myfarete Laze....

*Kape ditën tënde,
Mos e mbyl atë me lot,
Mos i thuaj, mos i thuaj vetes,
Të rrosh a të mos rrosh.
Hape zemrën, ndize shpresën,
Të jetojë me ty njeri,
Edhe mos thuaj duke ndenjtur,
Më shpëto o Perëndi.*

...

Zoti na ndriçoftë hapat tona në jetë dhe na bashkoftë përherë në sfida plot urtësi!...

NË DRITËSINË E ZOTNI MUHAMET SOKOLIT...

Baba jem, rahmet pastë, përherë më fliste me respekt për këtë burrë të urtë dhe fisnik, sa herë takoheshim në xhami, por jo vetëm..!

Më fliste me shumë admirim për zotni Muhamet Sokolin, sportistin e dalluar të rinisë së tij, “kolosin e basketbollit shkodran”, siç e njohin specialistët. E përmendte përherë për tiparet e tij, që e bënin të dalluar në mesin e shumë prej bashkëmoshatarëve...

xhaminë tonë, u ngrit në këmbë, me gjithë moshën e thyer dhe dhimbjen e gjunjve... (Vazhdon të rrezatojë mirësi e dritë, duke më bërë ta dua e ta respektoj, çdoherë e më shumë!)

Folëm e folëm, me të njëjtin respekt e dashamirësi, zotnia e tij në pozitën e të urtit, që kujdeset për personin që ka para syve, si një prind zemërgjerë me fëmijën e tij; unë, në pozitën e atij që e falënderon Allahun pambarimisht, që nuk e ndan nga prania e burrave të urtë



TASHMË 93 VJEÇAR, ËSHTË AKOMA ATY, NË PRAGUN E TIJ, NË NJË CEP, QË NJIHET SI “VENDI I PROFESOR MUHAMET SOKOLIT”, PËRBALLË HATIBIT, QË I SHNDRISIN SYTË, SAHERË NGRIHET PËR TË MBAJTUR HYTBEN E XHUMASË DHE PËRBALLË SHEH FYTYRËN E QESHUR E NË LUTJE TË ZOTNISË SË MOÇËM SHKODRAN...

Subhanallah, kështu, fin, serioz, babaxhan, fjalëurtë, besimtar, në rresht të parë, dashamirë e fytyrë qeshur e njoh zotni Muhametin, që ditën e parë që hyra në xhami të Tophanës dhe deri më sot... Tashmë 93 vjeçar, është akoma aty, në prapun e tij, në një cep, që njihet si “vendi i profesor Muhamet Sokolit”, përballë hatibit, që i shndrisin sytë, saherë ngrihet për të mbajtur hytben e xhumasë dhe përballë sheh fytyrën e qeshur e në lutje të zotnisë së moçëm shkodran...

Këtë të xhuma, sapo u pamë në

e të mirë, në jetën e tij!

Asht tabani, qytetaria, besimi e nuri i tij, nëpërmjet të cilëve, Zoti na tregon se ky model e kjo vulë, është ajo e zotnive muslimanë të Shkodrës, fryma e baballarëve e gjyshërve, të parëve, që na trashëguan vlerat dhe qytetarinë e brumosur me preket fisnikëruese të këtij Islami madhështor, me të cilin, na nxori nga errësirat në dritë!

Bekim i madh për mua, për ne!

Imam Muhamed B. Sytari

Shkodër, më 30 prill 2023

GËZUAR BAJRAMIN!



Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Jetojmë në një kohë shumë të vështirë ku çdo ditë e më shumë po zbukurohet e keqja dhe po bëhet si e mirë. Mundësia për të bërë gjynahe është shumë e madhe, madje ka nxitje, inkurajim dhe thirrje për gjynahe.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë. Më i miri prej tyre është ai që pendohet.”¹ Nëse shejtani të kujton të shkuarën, atëherë kujtoji atij të ardhmen (zjarrin e xhehenemit).

Faktorët kryesorë që na ndihmojnë që të mbrohemi nga gjynahet:

1. Dituria dhe njohja e gjynahut. Në momentin që përballesh me një gjynah lexo, pyet, njihi me pasojat dhe ndikimet e tij. Nëse vepron në këtë mënyrë, atëherë në brendësinë tënde krijohet një forcë e brendshme, e cila të bën më të kujdesshëm dhe më të frenuar përballë gjynahut. Lexo dhe informohu në lidhje me gjynahet në mënyrë që të mbrohesh prej tyre ashtu sikurse lexon kur përhapet ndonjë virus.

1. Transmetuar nga Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe.

SI TË MBROHEMI NGA GJYNAHET?

Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“Të gjithë bijtë e Ademit janë gabimtarë. Më i miri prej tyre është ai që pendohet!”

2. Dashuria për Allahun. Të duash dikë nënkupton që zemra jote anon drejt tij/saj. Zemra do shumë gjëra, por tek ajo që anon më shumë, sigurisht që ka më shumë dashuri. Njeriu kur e do dikë nuk e kundërshton dhe nuk ia prish qejfin, por tenton që t’i përshtatet në gjithçka atij. Sa më e madhe dhe e fuqishme që është dashuria jonë për Allahun, aq më shumë forcohet edhe qëndrueshmëria jonë përballë gjynaheve.

3. Vetëdija për begatitë e Allahut. Njeriu gëzon aq shumë mirësi e begati prej Zotit, sa që po të përpiquej t’i numëronte nuk do t’ia dilte, sepse ato janë të pafundme. Allahu (xh.sh) thotë: “Edhe nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato.”²

Mirësitë dhe begatitë e Zotit ndaj teje përdori në bindje ndaj Tij dhe jo duke bërë gjynahe. Përderisa Zoti të ka dhënë sy, shiko atë që Ai ka lejuar; Zoti të ka dhënë veshë, dëgjo atë që Ai kënaqet; fuqinë përdore për të bërë vepra të mira; intelektin përdore në të mirë të njerëzimit e kështu me radhë. Pra, të gjitha mirësitë që të ka dhënë Zoti t’i përdorësh për mirë. Do të ishte paturpësi, poshtërsi e mosmirënjohje që me të mirat që të ka dhënë Zoti ta kundërshtosh Atë.

Gruaja e ministrit, e cila ishte e

2. Kur’ani, En-Nahl: 18.

bukur dhe me pushtet u përpjek që ta joshte Jusufin (a.s) ia mbylli të gjitha dyert duke e kërcënuar atë me dënim e burg në qoftë se ai nuk u përgjigjej kërkesave të saj. Përballë kësaj situatë Jusufi tha: “Allahu më ruajt! Zotëria im (bashkëshorti yt), me plot bujari më nderoi e më strehoi (duke më mbajtur pranë vetes si të besuarin e tij dhe unë s’kam për ta tradhtuar).³ Bamirësia është ajo e cila e ndalon njeriun për të bërë keq.

4. Turpi ndaj Allahut. Turpi ndaj Allahut është një moral fisnik dhe një virtyt madhështor, i cili buron nga tri gjëra: E para: Të shikuarit në begatinë dhe mirësinë e Allahut me të cilën të ka begatuar. E dyta: Të shikuarit në mangësitë dhe neglizhencën tënde, në gjërat që të ka urdhëruar Allahu t’i veprosh dhe në atë prej të cilës të ka ndaluar. E treta: Të jesh në dijeni se Allahu të sheh në çdo gjendje dhe në çdo kohë, Atij nuk mund t’i fshihet asgjë. Nëse këto tri gjëra bashkohen në zemër, atëherë në të do të lëvizë një turp i madh ndaj Allahut, ndërsa nga ky turp do të burojnë çdo e mirë dhe çdo virtyt, siç thotë Pejgamberi (a.s): “Turpi sjell vetëm të mirë.”⁴

Pra, nëse në zemër gjendet turpi ndaj Allahut, atëherë robi i Allahut do

3. Kur’ani, Jusuf: 23.

4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

“Nuk e kam merak shqetësimin e gjynaheve, ngaqë jam i bindur se ato janë duke u fshirë, sepse unë vazhdimisht jam duke kërkuar falje për to te Zoti. Por ajo që po më shqetëson më shumë se falja e gjynaheve është turpi, se si do të dal përpara Allahut, i Cili më ka dhënë begati të shumta dhe do më pyesë se çfarë kam bërë dhe ku i kam përdorur ato!”

të largohet nga moralet e ulëta, nga veprat dhe sjelljet e këqija. Ndërsa në anën tjetër do të afrohet nga kryerja e obligimeve, do të kujdeset për morale të larta dhe sjellje të mira. Turpi e ndihmon njeriun të largohet nga gjynahet.

Një njeri i devotshëm ishte në momentet e vdekjes. Të pranishmit e vërejtën që ishte i shqetësuar (jo nga sëmundja, por nga një brengë shpirtërore) dhe për ta qetësuar ato i thanë: “Mos u shqetëso kaq shumë për gjynahet e tua, se Allahu është falës e do të t’i falë ato”. Ai u tha të pranishmëve: “Nuk e kam merak shqetësimin e gjynaheve, ngaqë jam i bindur se ato janë duke u fshirë, sepse unë vazhdimisht jam duke kërkuar falje për to te Zoti. Por ajo që po më shqetëson më shumë se falja e gjynaheve është turpi, se si do të dal përpara Allahut, i Cili më ka dhënë begati të shumta dhe do më pyesë se çfarë kam bërë dhe ku i kam përdorur ato!”

5. Frika ndaj Allahut. Frika ndaj krijesave të bën të arratisesh e të fshihesh prej tyre ose të ndërmarrësh ndonjë qëndrim ndaj tyre. Kurse frika prej Zotit të bën të shkosh drejt Tij, të kthehesh tek Ai, t’i kërkoj falje e mëshirë. Ebu Hurejra (r.a)⁵, sahabinu që transmetoi më së shumti hadithe nga Pejgamberi (a.s) kur i erdhi vdekja filloi të qajë. E pyetën pse po qan dhe ai u përgjigj: “Nuk po qaj pse po e lë këtë botë, por po qaj se rruga është shumë e gjatë, ndërsa përgatitja ime është e paktë. Tashmë erdhi koha për të qenë mes hyrjes në xhenet ose hyrjes në xhehenem dhe nuk e di se ku do më dërgojnë!”⁶

Jahja ibn Muadh (v. 258 h.), i njohur me emërtimin “I urti i kohës së vet”, ka thënë: “Mashtrimi më i madh, sipas meje, është të shpresosh për falje duke vazhduar në gjynahe dhe pa u penduar me keqardhje; të shpresosh t’i afrosh Allahut pa adhurime; të presësh frytet e xhenetit duke mbjellë farat e xhehenemit; të kërkoj xhenetin duke bërë gjynahe; të presësh shpërblimin pa punuar; të shpresosh nga Allahu duke shpërfillur punët e mira.”⁷

I lutemi Allahut të Madhëruar që të na bëjë nga ata njerëz, që ruhen nga gjynahet dhe pendohen për ato që kanë bërë.

5. Ebu Hurejra (r.a) - (Abdurrahman ibn Sakhr) ka transmetuar 5374 hadithe. “Hadha huve Ebu Hurejra”, f. 15.

6. Sijer Ealam En-Nubela, 2/625.

7. Tezkijetun-Nufus, Ahmed Ferid, f. 114.

NË XHAMINË E FSHATIT SHIRQ-MUSHAN, KU FËMIJËT MBAJNË TË NDEZUR PISHTARIN E AMANETIT TË BABALLARËVE!

Përgjatë Muajit të Begatë të Ramazanit, në të gjitha xhamitë e Shkodrës zhvillohen aktivitete, ligjërata, këshillime, iftare e tubime të dobishme, që në vetvete përkthejnë më së miri frymën e këtij Muaji të rimëkëmbjes, gjallërimit të shpirtit dhe përcjelljes së vlerave të besimit në gjithësi!



Pa dyshim, kontributi i vyer i shumë imamëve tanë të nderuar, kthehet në një borxh moral në hak të edukatorëve, mësuesve dhe përhapësve të fesë tonë në realitetet e xhamive dhe përtej tyre; borxh moral, që nuk shlyhet dot me asnjë lloj shpërblimi, të qenë a të paqenë, të merituar a të mohuar, të shlyer a të injoruar ndër dekada!

Përgjatë këtij Muaji, kam qenë në kontakt të vazhdueshëm me stafin e ngushtë, me imamë dhe këshilltarë, me xhematin dhe besimtarët, nëpërmjet takimeve ditore, vizitave në xhami, në mexhlin e hatmes a në namazit e teravisë, por jo vetëm.

Kam marrë dhe kam dhënë, kemi diskutuar e jemi këshilluar në mes vete, për atë që është më e mira dhe, për të cilën shpresojmë vetëm të jetë pranuar nga Zoti i gjithësisë, Allahu i Madhëruar.

Pa dyshim, se një ndër xhamitë e spikatura për ruajtjen e frymës së këtij Muaji dhe gjallërimin e tij nëpërmjet përkushtimit të imamit dhe përgjigjes së familjeve muslimane dhe brezit të ri në veçanti, është edhe xhamia e fshatit Shirq-Mushan!

Ndoshta, shumëkush as që e di se ku bie ky fshat, por nuk është ky qëllimi i këtyre rreshtave.

Ajo që dua të theksoj është fakti i pamohueshëm se, përtej zbrazjes së fshatit nga banorët, për shkak të largimit të qytetarëve të tij drejt vendeve të ndryshme të botës për kushte më të

mira jetese dhe, për të kapërcyer pragun e rrëmujës dhe anarkisë, skamjes dhe mospërfilljes së të drejtave të qytetarit; në xhaminë e Shirqit, akoma rrin ndezur një dritë...

Një dritë, sa 1000 pishtare, që përkujdeset për shërbimet e saj, imami i përkushtuar, veterani i aktivitetit fetar në xhamitë e Shkodrës dhe përtej, H. Kujtim Cufaj!

Në fillim të Ramazanit, më kontaktoi dhe më lajmëroi për nijetin e tij për të bërë itikaf krejt Muajin Ramazan në xhami!

Subhanallah! U habita dhe e përgëzoja, duke u lutur për mbarësinë e tij, që gjithsesi, me këtë veprim të përsëritur ndër vite, po dëshmonte përkushtimin ndaj fëmijëve të asaj zone në veçanti, pa përmendur komunitetin e përzier, muslimanë e katolikë, të cilët e duan të gjithë dhe e respektojnë Hoxhën pajtimtar e bamirës, fjalëmaturore e bashkues në mesin e njerëzve!

Edhe ditën e përrurimit të xhamisë, prifti i kishës katolike, ishte aty me ne, si të përshprehur mirënjohjen e tij dhe të komunitetit që përfaqëson, për të gjithë ne, por për Hoxhë Kujtimin në veçanti!


Çdo natë Ramazani, fëmijët janë xhemati kryesor i xhamisë Shirq-Mushan! Të rinjtë dhe të rejat janë yjet ndriçues të qiellit që mbulon këtë Shtëpi të shenjtë! Dhe, kjo meriton një falënderim dhe mirënjohje të madhe për Hoxhën e nderuar, por për çdo familje muslimane të kësaj zone, që ia ka besuar rrezet e shpirtit dhe dritën e syve, imamit dhe xhamisë!

Është dritë shprese, që pa dyshim na mbush me mirësi e bekim dhe na dëshmon madhësinë e misionit të edukatorit në jetën tonë, madhësinë e këtij Islami rregullator të jetës, madhësinë e këtij Muaji që na mban gjallë e na frymëzon drejt asaj që vjen, me mbarësinë dhe bekimet e Allahut!

Allahu i bekoftë fëmijët tanë, i nderoftë imamët dhe prijësit tanë fetare dhe na bëftë prej rregullatorëve me krenari, udhëzuesve me dinjitet, pajtimtarëve me urtësi!

Imam Muhamed B. Sytari

*Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 19 prill 2023*

Nexhat Ibrahim, *studues*

BAJRAMI TE MYSLIMANËT

Bajrami është festë myslimane dhe bazohet në burimet islame. Kurani thotë: “Prandaj falu për Zotin tënd ...!” (El-Kevther, 2) dhe “Shpëtimin do të arrijë ai që pastrohet (nga të këqijat) dhe që e përmend emrin e Zotit të vet dhe falet!” (El-A’la, 14-15).

Komentuesit e Kuranit mendojnë se fjalët falu (fe sal-li) dhe falet (fe sal-lâ), janë në lidhje me faljen e namazit të bajramit.

Edhe në traditën myslimane shqiptare, kudo qoftë, bajrami zë vend të veçantë qysh prej mesjetës. Gjatë kësaj date nëpër histori janë shënuar ndodhi të ndryshme politike e ushtarake, por edhe arritje fetare e kulturore. Madje bajrami ka qenë festë mbarëpopullore, sepse edhe jomyslimanët si pakicë, indirekt solidarizoheshin në festë me myslimanët si shumicë dërrmuese, duke pastruar ambientet jashtë dhe brenda shtëpisë, duke mos bërë ndonjë veprim që mund t’i irritonte fqinjët myslimanë etj. Bajrami ishte festë kohezioni, mëshire, dashurie, altruizmi e patjetër edhe pajtimi mes njerëzve nga hidhërimet e inatet e ndërsjella.

PËRGATITJET PËR BAJRAM

Shënimi i bajramit në trojet tona ka histori të gjatë, madje qysh në mesjetë, kur myslimanët ishin në këto troje në numër të konsiderueshëm, por të atakuar ashpërsisht nga kundërshtarët

BAJRAMI I RAMAZANIT MES SË KALUARËS DHE TRENDEVE TË REJA NDËR SHQIPTARË

janë asimiluar apo janë shndërruar në skllevër, janë larguar dhunshëm apo edhe janë vrarë në përlëshje të ndërsjella me kundërshtarët.

Bajrami ndër myslimanët është shënuar në pajtim me normat e së lejueshmes të festave islame, por edhe me karakteristika lokale e rajonale të vendit të caktuar. Fillimi për përgatitje për bajram fillon më herët, por përgatitjet intensifikohen sidomos prej Natës së Kadrit. Islami i kushton rëndësi të theksuar pastërtisë shpirtërore dhe fizike, individuale dhe kolektive.

Derisa pastërtia shpirtërore është proces i gjatë, i përditshëm

kërcitjen e topit nga ndonjë vend i përshtatshëm për t’u dëgjuar më mirë, siç bëhej në Prizren nga Kalaja, siç bëhej edhe për të treguar fillimin e iftarit dhe kohën e syfyrit. Dikur, topi lajmëronte edhe fundin e Ramazanit, duke kërcitur tri herë në iqindi të ditës së fundit të Ramazanit, kurse gjatë ditëve të bajramit, nga topat me kalibra të ndryshëm kërcitej si shenjë feste, gëzimi etj. Topi përdorej edhe për raste tjera me rëndësi fetare ose shtetërore. Nuk duhet harruar se ndër parapërgatitjet e bajramit është edhe dhënia e sadakatul-fitrit, patjetër para faljes së namazit të bajramit. Kjo sadakë është e drejtë e Bashkësisë Islame (si ushtrues i pushtetit fetar të Bejtul-Malit), në dobi të kategorive kuranore (Shih: Et-Teube, 60).

DREKA E BAJRAMIT E TË TJERA

Në mëngjesin e hershëm të bajramit, të gjithë familjarët ngriheshin nga gjumi, merrnin abdest, vishnin petkat më të mira që kanë pasur për t’i dhënë shkëlqim e atmosferë festimit të bajramit. Meshkujt dhe djemtë e rritur shkonin në xhami për të falur bajramin. Pas namazit, falësit i uronin njëri-tjetrit festën.

Nuk kemi ndonjë mënyrë të saktësuar

se si bëhet urimi nga vetë Muhammedi a.s., por sahabët kanë transmetuar se njëri-tjetrit ia uronin me fjalët “Tekabbel’all-llahu mina ve minkum!”, që domethënë: “Allahu e pranoftë nga ne dhe nga ju!” (Hadithi hasen, sipas Ibn Haxherit në Fet’h’ul-Bari).

Te ne zakonisht përdoren fraza të caktuara për urim të njëri-tjetrit, si: Me fat bajrami/ Me fat edhe juve; Për hajr bajrami/ Hajr paçi; E gëzofshi bajramin/ E gëzofshi edhe ju; Bajram mubarek olsun/ Allah razi olsun etj. Kohët e fundit ka ndryshime të caktuara në pikëpamje të urimit të festës dhe këtë e ka kushtëzuar mënyra e jetesës,

teknologjia e avancuar etj. Tash përdoren telefonat, mesazhet nëpërmjet rrjeteve sociale në internet etj.

Ndonjëherë ky moment përcillet me tupanë e në disa vende edhe me kërcitjen e topit, e nëpër fshatra edhe me kërcitje pushkësh, zakonisht me fishekë baruti. Natën e bajramit tupanxhiu edhe njoftonte fundin e Ramazanit por edhe vizitonte çdo derë, duke kërkuar “hakun” e tij për shërbimin që kishte bërë gjatë muajit. Qendrore në ditën e parë të bajramit është ushqimi i gatuar për bajram. Përgatiten disa gjella, ndonjë lloj piteje, kulaçë të caktuar, ëmbëlsira të ndryshme e sidomos bakllavaja, revania e ndonjë tatli tjetër, sallatë sezone por edhe gatime të tjera përcjellëse. Ushqimi shtrohet zakonisht paradite, por edhe pas dreke në disa vende. Në fund të ushqimit bëhet edhe dua, në shenjë falënderimi ndaj Allahut për mirësitë e shumta të dhuruara. Në rast duaje kujtoheshin edhe të vdekurit dhe të dashurit e tjerë.

VIZITAT E BAJRAMIT

Dikur ditën e parë të bajramit së pari nga populli vizitohej ulemaja e vendit, dijetarët fetarë, pastaj njerëzit autoritativë të fshatit, lagjes, qytetit. Vizitorët gostiteshin me ndonjë sherbet, ëmbëlsirë sapo gjësende të tjera nga mikpritësit.

Në disa vende natën e bajramit e në disa vende ditën e parë e të dytë të bajramit vizitoheshin varrezat, gëlqeroseshin gurët e të vdekurve tanë. Këndohej edhe ndonjë pjesë Kurani. Është për t’u përhëndetur veprimi i Bashkësisë islame të Bosnjës, e cila ditën e dytë të bajramit të ramazanit e ka caktuar si ditë të shehidëve, dhe kjo ditë çdo herë e më shumë po bëhet tradicionale. Veprim shumë i drejtë dhe orientim i besimtarëve drejt vlerave të përbashkëta.

Dita e dytë dhe e tretë në disa vende u është lënë vizitave në fqinjësi, së pari më i vjetri e pastaj me radhë vizitonin çdo shtëpi të lagjes. Nuk harroheshin as të sëmurët, as të varfrit e lagjes. Vizitorët gostiteshin me çaj, kafe, ndonjë ëmbëlsirë apo ndonjë gjë tjetër, varësisht nga tradita vendore. Në fund shpërndahen nëpër shtëpitë e tyre.

Vetëm kah fundi madje edhe pas bajrami, gratë fillojnë vizitat e tyre, dhe kjo quhet te ne “bajrami i grave”. Në të kaluarën nëpër ambiente xhamie, namazxhahu apo në shesh të fshatit organizoheshin tubime, lojëra apo

ndonjë argëtim në shenjë bajrami. Kohët e fundit gjithashtu bëhen ca organizime kulturore e argëtuese, por këto tubime bëhen me qëllime komerciale dhe përplot haramë (alkooli, lakuriqësia etj.). Po braktisen traditat fetare e tradicionale e po zëvendësohen me gjëra të dëmshme për fenë, shoqërinë, trashëgiminë kulturore e qytetërore. Organizimet e mira mbaheshin mend një kohë të gjatë dhe ndikonin pozitivisht edhe te fëmijët e rinia.

Viteve të fundit mënyra e vizitave për bajram dhe përmbajtja e vetë vizitave ka ndryshuar. Më nuk ka vizita përjashtimisht të botës mashkullore, as me ditë të caktuara. Mbase kjo edhe për shkak të rrethanave të imponuara të kohës, sepse obligimet në punë imponojnë edhe përcaktimin ndryshe të vizitave.

Me një rast rrëfen Aishja r. anha se si Pejgamberi i Zotit a.s. e ka ulur në një vend e ajo shikonte habeshitë të cilët luanin me shtiza në mesxhid. Kur i pa Omeri r.a. i qortoi ata, kurse Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Lëri! Nëna jonë është nga Benu Erfide”. (Buhariu).

Hadithet e shumta tregojnë se gjatë ditëve të bajramit është e lejuar të relaksohemi, të argëtohemi, pas një angazhimi të madh shpirtëror dhe fizik, të agjërimit dhe ibadeteve tona. (Fet’hu’l-Bari).

Ja edhe një shembull konkret me Ebu Bekrin r.a., i cili me një ditë bajrami e vizitoi të bijën e tij, Aishen r. anha, në shtëpinë e Muhamedit a.s. Aty takoi dy shërbëtore që këndonin në shenjë feste. Ebu Bekri r.a., i prekur nga kjo gjendje, si baba, e qortoi Aishen r. anha, duke bërtitur: “Vallë, kënga në shtëpinë e Pejgamberit të Zotit?!“ Pejgamberi i Zotit, i kthyer me shpinë nga ana tjetër, u kthye dhe tha: “O Ebu Bekër, lëri! Çdo popull i ka festat e veta, kurse kjo është festa (bajrami) jonë.”

TË HUAJT PËR FESTËN E BAJRAMIT

Festa e bajramit i ka impresionuar edhe tregtarët e huaj e edhe diplomatët e huaj, por edhe udhëpërshkruesit e ndryshëm. Këtë e vërejmë edhe nga Evlija Çelebiu, i cili shkruan për traditat e ndryshme nëpër vendet myslimane në trojet shqiptare. Por, kjo i ka bërë përshtypje edhe jomyslimanëve, të cilët mahniteshin me koloritin e veshjes, veglave të punës, të luftës, të rekreacionit e të tjera. Sidomos u kishte bërë përshtypja veshja e prijesve fetarë myslimanë, pastaj bukuria e vajzave me

shamitë e tyre, që krijonin përshtypjen e botës së magjisë.

Ndër ta ishte edhe Lord Bajroni, i cili në një poezi shkruan:

Ja shqiptarët, sesi në mënyrë krenare ulen drejt tokës
Pranë tyre, grekët, mbajnë
belbëzimin Dëgjo! Nga xhamia himni i natës

po buçet
Thërritja e muezinit sa nuk po shkund minaretë,
Nuk ka Zot përveç Allahut – për në lutje – Pse vërtet!
Zoti është më i Madhi!

Nga i njëjti autor kemi edhe një poezi të mrekullueshme:

Tokë e Shqipërisë
Lërma shikimin tim të endet mbi ty
Në ty, vend i ashpër me burra të fortë
Ku kryqi bie dhe minaret ngrihen
Ku drita e gjysmëhënës ndriçon në lugina

Edhe pse shumë selvi rriten nëpër rrethina.

PËRFUNDIM

Shënimi i festës së bajramit ndër shqiptarë edhe më tutje i kushtohet kujdes, ndonëse pak me ndryshe se dikur. Edhe pse shënimi i festës vazhdon të bëhet, mënyra ka pësuar ndryshime paksa, sidomos nga ndikimi i modernizmit dhe vrazhdësisë së teknologjisë. Fragmentarizimi dhe tëhuajësimi i familjes tradicionale, jetesa larg trungut familjar, martesat larg vendit të origjinës, i kanë futur një heterogjeni në agjendën e vet festës, kanë sjellë praktika të reja dhe zbehje të traditës.

Është e qartë se mënyra tradicionale e shënimit dhe festimit të bajramit nuk ka kthim, por edhe abuzimi me të është i papranueshëm. Zëvendësimi i tyre me mënyra antiislame nuk është as e ndershme as e lejueshme fetarisht. Është detyrë e prijesve fetarë të gjejnë modele të shënimit të bajramit dhe festave fetare në rrethanat e reja ideologjike dhe kushtet teknologjike të kohës. Nëse prijesit fetarë do të vonohen me përgjigje, praktika nuk do të vonohet ndërsa besimtarët tanë do të jenë larg mësimave dhe trashëgimisë myslimane.

(marrë nga: “Dituria Islame” - nr. 330)

IFTARI I FAMILJES DHE PROGRAM FESTIV

Të dielën, më 16 prill 2023, në ambientet e pallatit të sportit “Qazim Dervishi”, Myftinia Shkodër organizoi një program fetaro-artistik si dhe iftarin e madh të familjes me një pjesëmarrje të madhe të besimtarëve dhe qytetarëve shkodranë.

Pas hapjes së këtij aktiviteti nga teologu Arben Halluni, grupi artistik i nxënësve të xhamisë Bardhaj, me praninë edhe të disa nxënësve të xhamive Barbullush dhe Oblikë, paraqitën një program të pasur fetaro-artistik, duke performuar në mënyrë të mrekullueshme ajete kur'anore, thënie profetike, ilahi, poezi, recitime, etj.

Pas këndimit të ezanit të akshamit nga hafizët turq, të ardhur enkas nga Diyaneti i Turqisë për të shërbyer në xhamitë e qytetit, u bë çelja e iftarit përmes përshëndetjeve të rastit nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari, i cili gjatë përshëndetjes, ndër të tjera tha:

“Pa dyshim, është një mirësi shumë e madhe që jemi në këtë iftar të begatë, iftari i madh i familjes, nëpërmjet të cilit ne përcjellim mesazhin më të madh dhe më të rëndësishëm, për të cilin kemi nevojë sot dhe mot, për t'i kujtuar njëri-tjetrit, shoqërisë sonë dhe mbarë njerëzimit se ky është themeli dhe bërthama e asaj me të cilën Zoti i Gjithësisë na solli në këtë botë dhe na udhëzoi drejt saj!”.

Në vijim, përshëndetën edhe mysafirët e nderuar nga trevat shqiptare, respektivisht kryetari i Bashkësisë Islame të Prizrenit, H. Besim Berisha dhe kryetari i Bashkësisë Islame të Ulqinit, z. Hysni Begu.

Më pas, të gjithë të pranishmit shijuan iftarin e vëllazërisë islame, duke vijuar ndërkohë edhe ndjekjen e programit nga grupi artistik i fëmijëve dhe fotomontazhin e aktivitetëve të ndryshme të Myftinisë Shkodër gjatë vitit.



DAGESTANI OSE REPUBLIKA E DAGESTANIT

Dagestani, ose Republika e Dagestanit, është një republikë në Rusinë jugperëndimore, që shtrihet në skajin lindor të anës veriore të vargmalit Kaukazi i Madh, përgjatë bregut perëndimor të Detit Kaspik. Dagestani kufizohet me Kalmikinë në veri, Stavropol Krai në veriperëndim, Çeçeninë në perëndim, Gjeorgjinë në jugperëndim dhe Azerbajxhanin në jug, kurse ana lindore e tij laget nga ujërat e Detit Kaspik.

Dagestani ka një sipërfaqe prej 50300 km², dhe një popullsi prej mbi 3.209.800 banorësh (sipas ru.wikipedia.org, 2023).

Kryeqyteti i vendit është **Mahaçkala**.

GJEOGRAFIA

Dagestan, në turqisht, do të thotë “vendi i maleve”. Dhe vërtetë, pjesët jugore dhe qendrore të Dagestanit janë të pushtuara nga malet e Kaukazit, prej nga burojnë lumenjtë e shumtë të tij. Nëpër territorin e Dagestanit kalojnë lumenj të mëdhenj si Terek, Sulak dhe Samur, të cilët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në furnizimin me ujë të rajonit të Kaukazit, pa përmendur stacionet hidroelektrike të vendosur mbi këta lumenj, nga të cilët rajoni i jugut të Rusisë furnizohet me energji elektrike.

Dagestani mund të ndahet në pesë rajone fizike. I pari, që zë pjesën më të madhe të gjysmës jugore të republikës, përbëhet nga malet e Kaukazit. Kufiri jugor i Dagestanit shkon përgjatë kreshtës kryesore, e cila ngrihet në 3.648 metra në malin Guton, dhe 4.466 metra në malin Bazardjuzju. Në veri të vargmalit Kaukazi i Madh, gjendet Malësia e Brendshme e Dagestanit, e përbërë nga malet shumë të përthyera Andiski-Salatau dhe Gimrinski. Këto male priten nga luginat e thella dhe kanionet e shumë lumenjve të shpejtë që rrjedhin për në detin Kaspik, veçanërisht lumenjtë Samur, Sulak dhe Kurakh. Reshjet janë shumë të pakta në male, dhe zona të mëdha atje janë të zhveshura nga bimësia.

Rajoni i dytë, që gjendet në veri të këtij kompleksi malesh, është ai i kodrinave, rreth 19 - 40 km i gjerë, dhe që ngrihet në 600–900 metra mbi nivelin e detit. Ky rajon preket nga reshjet dhe për këtë arsye, mbulohet nga pyjet e dendura. Në shpatet më të ulëta të këtij rajoni rriten gështenjat.

Rajoni i tretë përfaqësohet nga fusha e ngushtë bregdetare, që shtrihet midis maleve dhe Detit Kaspik. Kjo fushë ka një gjerësi prej 3–32 km, dhe përshkohet nga lumenjtë që derdhen në detin Kaspik. Fusha është e mbuluar nga sedimentet detare, dhe është ky vendi ku ndodhen edhe nafta e gazi natyror.

Rajoni i katërt konsiderohet vazhdimi i fushës bregdetare për në veri, në pjesën më të ngushtë të republikës, dhe përbëhet nga fusha e ulët moçalore që gjendet në rrjedhën e poshtme të lumit Terek, dhe nga delta e tij. Së fundi, rajoni i pestë shtrihet në veri të lumit Terek, ku harta e Dagestanit zgjerohet përsëri

tjera përfshijnë ndërtimin e makinerive, inxhinierinë energjetike, prodhimin e materialeve të ndërtimit, punimin e drurit, prodhimin e qelqit, përpunimin e ushqimit, etj. Përpunimi i hekurit dhe endja e qilimave janë zeytari tradicionale në vend. Energjia hidroelektrike merret nga stacionet energjetike të ndërtuara mbi lumenjtë Karakojso, Terek, dhe Sulak.

Pjesa më e madhe e popullsisë e siguron jetesën nga bujqësia, kryesisht nga blegtoria, pasi vetëm 15 për qind e tokës është e punueshme. Delet - në veçanti - mbahen në numër të madh në Dagestan. Për shkak të tokës së



për të përfshirë pjesën më të madhe të fushës ranore të stepës së Nogaj, e deri në lumin Kuma, i cili formon kufirin verior të republikës.

KLIMA

Në tërësi, Dagestani ka një klimë të moderuar kontinentale, zakonisht të ngrohtë dhe të thatë. Muaji më i ngrohtë në Dagestan është Gushti, me temperaturë mesatare maksimale 32°C, dhe muaji më i ftohtë është Janari, me temperaturë mesatare maksimale të ditës 4°C.

EKONOMIA

Dagestani është i pasur me naftë dhe gaz natyror. Ka gjithashtu depozita qymyri, xehe hekuri, minerale të ndryshme, dhe metale të rralla. Aktiviteti industrial përqendrohet në burimet e naftës dhe gazit natyror të fushës bregdetare pranë qyteteve Mahaçkala dhe Izberbash. Industritë e

pakët të punueshme, kodrat shpesh janë të përshtatura për prodhim, në formë brezaresh. Në rajonin e deltës së lumit Terek dhe në fushën bregdetare, kultivohen perime, dhe fruta të tilla si qershitë, kajsitë, mollët, dardhat dhe pjepri. Kulturat kryesore të drithërave janë gruri, misri dhe orizi (në deltën e lumit Terek). Peshkimi është gjithashtu i rëndësishëm përgjatë detit Kaspik. Hekurudhat lidhin Dagestanin me Moskën, Bakunë, Astrakhanin dhe Gudermes-in, dhe rrugët automobilistike lidhin të gjitha stacionet hekurudhore të republikës. Kaspiku përshkohet nga rrugë detare për në Mahaçkala, ku gjendet porti kryesor i vendit.

GJUHA

Dagestani ka diversitet të madh etnik, ku më të mëdhenjtë midis atyre grupeve etnike janë avarët, rusët, darginët, kumikët dhe lezginët, dhe të cilët së bashku përbëjnë pjesën më të madhe të

popullsisë. Shumica e grupeve etnike në Dagestan flasin gjuhë kaukaziane, turke, ose iraniane, megjithatë, rusishtja është gjuha kryesore në republikë.

Mes banorëve të Dagestanit, veçanërisht në mesin e dijetarëve muslimanë, përveç gjuhës së tyre flitet dhe gjuha Arabe, gjuha e Kur'anit.

FEJA

Islami është feja dominuese në vend, e përqafuar nga 97% e popullsisë. Pjesa e mbetur e popullsisë i përket besimit të krishterë, hebre, ose feve të tjera.

HISTORI

Nga shekulli i 5-të p.e.s, Dagestani ishte pjesë e Albanisë Kaukaziane. Gjatë fushatave ushtarake të muslimanëve arabë, populli i Dagestanit (rajoni i Derbentit) ishte populli i parë që u bë mysliman brenda territorit aktual rus (viti 643. h). Në shekullin e 8-të, arabët muslimanë u përplasën vazhdimisht me khazarët. Islami u adoptua në qendrat urbane, si Semender dhe Kubachi, nga ku depërtoi vazhdimisht në malësi. Në shekullin e 15-të, krishterimi kishte vdekur në Dagestan, duke lënë prapa vetëm një kishë të shekullit të 10-të.

XHAMIA E MADHE, MAHAÇKALA



Në shekullin e 10-të, myslimanët arabë u pasuan nga turqit selxhukë, të ndjekur në shekullin e 13-të nga mongolët dhe Hordhia e Artë, pasardhës të së cilës janë etnia Nogai e Dagestanit. Perandoria Osmane dominoi rajonin në shekullin e 16-të, dhe Persianët në shekullin e 18-të.

Pas luftërave Napoleonike, Perandoria Ruse u përpoq të shtrinte ndikimin e saj në Kaukaz. Lufta Kaukaziane e viteve 1816-1856, është periudha më e famshme e historisë së Dagestanit, veçanërisht të etnisë Avare. Nën udhëheqësin e tyre karizmatik Imam Shamilin, nëpërmjet një lufte të përgjakshme dhe heroike, ata i rezistuan përparimit rus. Nga fundi i shekullit të 19-të, miliona kaukazanë ose ishin vrarë ose ishin detyruar të emigronin në Perandorinë Osmane. Emigrimi i mëpasshëm i rusëve dhe



KRYEQYTETI, MAHAÇKALA

popujve të tjerë të krishterë drejt rajonit, e ndryshoi rrënjësisht ekuilibrin ndëretnik në shumicën e rajoneve të Kaukazit.

Dagestani qe depërtuar nga rusët që nga shekulli i 15-të. Pas një marrëveshjeje që ishte bërë mes Rusisë dhe Iranit, në vitin 1813 rajoni ishte aneksuar nga Rusia, kurse kontrolli i plotë i saj mbi zonën, u arrit në vitin 1877. Pas Luftës Civile Ruse, më 20 Janar të vitit 1921, Dagestani u shpall një vend autonom, dhe u quajt: Republika Socialiste Sovjetike Autonome e Dagestanit.

Pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, statusi ligjor i republikës ndryshoi në: Republika e Dagestanit.

SI HYRI ISLAMI NË DAGESTAN?

Kontakti i parë i muslimanëve me këtë rajon ishte në epokën e kalifit Omer ibnul-Hattab, kur ai dërgoi atje një ushtri të udhëhequr nga sahabiu Amr ibn Suraka. Ushtria arriti në Babul-Ebvab (Derbent) në vitin 23 hixhri. Në qytet nuk u zhvillua asnjë luftim, por u nënshkrua një marrëveshje unike paqeje. Komandanti i ushtrisë myslimane pranoi atë që pranoi Shehrpazar, mbreti i këtij qyteti, dhe që ishte: Luftimi përkrah muslimanëve, në vend që të paguanin xhizjen. Prijësi i besimtarëve, Omer ibnul-Hattabi (r.a), e miratoi këtë marrëveshje. Kështu, ky qytet u kthye në një bazë për myslimanët, nga ku ata niseshin në fushatat ushtarake kundër armiqve të tyre.

Nga qyteti Babul-Ebvab, ushtritë e myslimanëve u drejtuan drejt Khazarisë dhe pjesës tjetër të tokave të Aranit dhe Armenisë. Bekir ibn Abdullah udhëhoqi një fushatë ushtarake në Mughan. Habib ibn Mesleme udhëhoqi një fushatë në Tbilis. Hudhejfe ibn Usejd udhëhoqi një fushatë në malet Alan. Selman ibn Rabia udhëhoqi një fushatë në kufijtë

e Armenisë. Kështu pra, qyteti Babul-Ebvab u bë si një pikënisje për shumë fushata ushtarake të muslimanëve.

Kalifi Omer ibnul-Hattab e urdhëroi Abdurrahman ibn Rabian të sulmonte rajonin e Khazarisë, kështu që ushtritë myslimane arritën në qytetin Balanxhar, dhe përparuan në veri deri në qytetin El-Bejda. Qyteti Babul-Ebvab ishte kthyer tashmë në një shteg për Islam, nga ku po përparonte drejt verilindjes së rajonit të Rihabit (kështu e quanin arabët myslimanë asokohe rajonin që përfshinte Aranin, Armeninë dhe Azerbajxhanin), drejt khazarëve dhe rusëve.

Përpjekja për përhapjen e Thirrjes Islame në ato rajone vazhdoi edhe në kalifatin e Othman ibn Affanit, në epokën Umejade, dhe atë Abaside.

Myftiu i Dagestanit, Shejh Ahmed El-Haxhi Abdullah, thotë: Dagestani ka qenë porta nga e cila Islami arriti në Rusi. Myslmanët e parë arritën atje gjatë epokës së Kalifit Omer ibnul-Hattab, pas 23 vjetësh nga emigrimi i Profetit (a.s). 40 sahabe janë të varrosur në Dagestan.

Në Dagestan kanë jetuar dijetarë të mëdhenj të shkencave fetare Islame, dhe ky vend dikur quhej Bahrul-Ulum (deti i njohurive). Në shkollat fetare ende mësohen librat e shkruar nga dijetarët dagestanë.

Aktualisht në Dagestan ka pesë mijë xhami, 10 institute Islame, dhe qindra shkolla për të mësuar Kur'anin e Shenjtë.

80% e haxhilerëve, që vijnë nga Rusia në Mekën e Shenjtë, për të kryer Haxhin, janë nga Dagestani.

Përgatiti:
Msc. Arta Ujkaj, teologe

<https://www.britannica.com>
<https://www.marefa.org>
<https://ru.wikipedia.org>
<https://www.refworld.org>
<https://www.albayan.ae>
<https://en.wikipedia.org>

"HELPING HAND FOR RELIEF AND DEVELOPMENT", NDIHMOM FAMILJET SHKODRANE PËR RAMAZAN

Përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me Myftininë Shkodër, "Helping Hand for Relief and Development" ka vazhduar edhe këtë vit shpërndarjen e pakove ushqimore gjatë muajit të Begatë të Ramazanit 1444/2023.

Falë këtij bashkëpunimi me vlerë, këtë vit u ndihmuan rreth 300 familje në nevojë në rrethin e Shkodrës, duke shpërndarë një sasi të konsiderueshme me produktet bazë të shportës ushqimore për çdo familje.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër falënderon "Helping Hand for Relief and Development", që kontribuon me projekte të larmishme bamirëse gjatë Ramazanit, por jo vetëm.



FËMIJËT E XHAMISË BARBULLUSH, BASHKË NË IFTARIN E RAMAZANIT

Muaji i begatë i Ramazanit mbledh gjithandej besimtarët në aktivitete e tubime të ndryshme. Quhet edhe muaji i forcimit të vëllazërisë dhe shtimit të bamirësisë dhe solidaritetit në mes vete.

Gjatë këtyre ditëve, në xhami të ndryshme të qytetit dhe fshatit, janë organizuar aktivitete dhe tubime që na bashkojnë e na afrojnë më shumë me njëri-tjetrin, duke na bërë ta shijojmë edhe më shumë çdo ditë e natë të këtij muaji.

Ligjëratat, iftaret vëllazërore, mexhliset e hapjes sherife, ndihmat për nevojtarët, etj., i japin kuptim atmosferës së këtij Muaji.



Të mërkurën e 5 prillit 2023, në ambientet e xhamisë së Barbullushit, nën drejtimin e imamit të kësaj xhamie, H. Ervis Molla, u mbledhën fëmijët frekuentues të kursit fetar të kësaj xhamie.

Në një atmosferë të begatë e plot dritë besimi e vëllazërie, të pranishmit ndanë bashkërisht lutjet e kësaj dite, si dhe kënaqësinë e prezantimit në sofrën e begatë të ifatrit.

Allahu (xh.sh) e pranoftë dhe na bashkoftë për të mira!



MYFTINIA SHKODËR DHE "JETIMËT E BALLKANIT" PRANË NJERËZVE NË NEVOJË ME 500 PAKO USHQIMORE

Paraditën e shtunë, më 8 prill 2023, në ditën e shtatëmbëdhjetë të muajit të Begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër bëri shpërndarjen e 70 pakove ushqimore për personat para-tetraplegjikë.

Teologu Lavdrim Hamja, në prani të mediave lokale ndër të tjera tha se, kjo ndihmë e sotme, vjen në sajë të bashkëpunimit me Shoqatën Bamirëse "Jetimët e Ballkanit", me drejtuesin e saj, humanistin e trojeve shqiptare H. Halil Kastrati, që me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit, i dhuroi Myftinisë Shkodër

500 pako ushqimore, të cilat u sollën para disa ditësh nga qyteti i Prizrenit.

Kryetari i Shoqatës së Para-Tetraplegjikëve, z. Saimir Beqiri falënderoi Myftininë Shkodër duke theksuar, se nën përkujdesjen e Imam Muhamed B. Sytari, u arrit kjo ndihmë me vlerë për personat para-tetraplegjikë, në këto ditë të bekuara të muajit të shenjtë të Ramazanit.

Ky projekt bamirës u realizua me sukses edhe falë bashkëpunimit me Zyrën Rajonal të Shërbimit Social, Shkodër, nën përkujdesjen e drejtoreshës, znj.



Valbona Tula.

Myftinia Shkodër do të vazhdojë në ditët e tjera të Ramazanit, me shpërndarjen e ndihmave të ndryshme të familjet në nevojë, jetimët, skamnorët dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara.

Edhe njëherë, një falënderim i veçantë për Shoqatën Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për Zyrën Rajonale të Shërbimit Social Shkodër, dhe për të gjithë ata persona, të cilët u angazhuan për mbarrëvajtjen dhe realizimit të këtij projekti bamirës të ndihmës së Ramazanit me 500 pako ushqimore.



MYFTIU I SHKODRËS LIGJËRON NË QENDRËN ISLAME KULTURORE SHQIPTARE NË NORVEGJI

Me ftesë të Qendrës Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, po qëndron për një vizitë disa ditore në Oslo të Norvegjisë.

Gjatë kësaj vizite, Myftiu mori pjesë në disa nga aktivitetet e QIKSHN-it, me rastin e Muajit të Ramazanit.

Në veçanti, ditën e xhuma, Myftiu mbajti ligjëratën para namazit të xhumasë, si dhe hytben e kësaj jave, në prani të një numri të madh besimtarësh nga trojet shqiptare, që jetojnë dhe punojnë prej dekadash në Oslo.

Në mesazhet e dhëna, Myftiu vuri theksin tek bekimet



e mëdha, me të cilat Allahu (xh.sh) i ka begatuar shqiptarët me përqafimin e Islamit dhe kthimin e tyre në ambasadorë të përkushtuar të fesë së Allahut, në çdo cep të globit.

Myftiu mori pjesë edhe në tribunën fetare të datës 7 prill 2023, ku së bashku me të nderuarin Dr. Tahir Asllanaj, ligjëroi mbi ripërtëritjen shpirtërore dhe shërimin fizik, që shkakton agjërimi i Ramazanit tek

Myftiu dha edhe një intervistë të gjatë për Radio Rilindja në Oslo, ku përcolli mesazhe me dobi, që lidhen me vlerat e Ramazanit, sikurse dha edhe përshtypjet e tij më të

mira për aktivitetin e Qendrës Islame Kulturore Shqiptare në Norvegji, si një kompleks shumëfunksional, themeluar që në vitin 1987.

Myftiu shprehu falënderimet e tij për Kryetarin e QIKSHN, H. Fatmir Shabani, imam i nderuar, H. Berat Hashani, si dhe stafin drejtues të qendrës.

Gjatë qëndrimit në Oslo, Myftiu Sytari u takua edhe me ambasadorin e Maqedonisë së Veriut në Norvegji, ShTZ. Driton Kuqi, i cili prezantoi edhe në aktivitetet e lartpërmendura.

TRIBUNË FETARE NË PËRKUJTIM TË BETEJËS SË MADHE TË BEDRIT

Ditën e shtunë, më 8 prill 2023, në xhaminë e Parrucës, u zhvillua një tribunë fetare me rastin e përkujtimit të Betejës së Madhe të Bedrit, organizuar nga Myftinia Shkodër.

Krahas shumë besimtarëve dhe të rinjve, merrnin pjesë edhe imamë të xhamive të Shkodrës.

Në fjalën e hapjes dhe të përshëndetjes, teologu Arben Halluni tha se “Muaji i Ramazanit, krahas aspektit



të adhurimit, është i përmbushur edhe me ngjarje të mëdha historike; Fillimi i Zbritjes së Kur'anit Famëlartë, Beteja e Bedrit dhe Çlirimi i Mekës”. Ai vuri në dukje se Beteja e Bedrit ishte ngjarje që mahiti mbarë botën islame për vendosmërinë e myslimanëve, trimërinë dhe heroizmin e tyre të pashembullt, por mbi të gjitha ndihmën e Zotit Fuqplotë që u shfaqë gjatë kësaj beteje kundër mushrikëve, idhujtarëve të Mekës”.

Më pas dy ligjëruesit, H. Ardit Ulqinaku dhe H. Anis Agovi folën për rolin e madh që ka luajtur Pejgamberi (a.s) në këtë betejë të madhe si dhe për shkaqet, mësimet dhe rezultatet prej të cilave duhet mësuar nga besimtarët në çdo kohë dhe në çdo vend.

Në fund, për të pranishmit u shtrua një iftar i begatë vëllazëror.



LUTJET TONA JANË PËR VËLLEZËRIT TANË NË PALESTINËN E PUSHTUAR MARTIRE



Lutjet tona janë për vëllazërit tanë në Palestinën e pushtuar martire, që vriten dhe dhunohen barbarisht, edhe në Muajin e shenjtë, edhe në brendësi të Xhamisë së Shenjtë!

Akte të tilla terroriste, si ai i natës së kaluar, në Xhaminë e Aksasë, në Kudsi Sherifë, përveçse të dënueshme, janë argument i qartë i dekadencës së njeriut pa fë, pa mëshirë e larg ekuilibrit të origjinës dhe natyrës së tij si qenie!



SOFRA E IFTARIT TË BEGATË ME NXËNËSIT E MEJTEPEVE TË XHAMIVE GUR I ZI DHE RRAGAM

Ditën e diel, më 9 prill 2023, në ditën e 18-të të muajit të begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër, përmes sektorit të arsimit organizoi iftarin e radhës, pas atij të Barbullushit, më nxënësit e mejtepit/kurseve fetare të xhamive Gur i Zi dhe Rragam.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 35 nxënësve të moshave të ndryshme të mejtepeve, imamëve të xhamive respektive Ridvan Frexhaj dhe Taksim P Lori, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu

Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, përmes një bisedë të shkurtër u dha nxënësve disa këshilla e mesazhe të dobishme edukative dhe besimore.

Në fund të iftarit, imami i xhamisë Gur i Zi, në të cilën u zhvillua edhe iftari, bëri dua-lutje si dhe më pas të gjithë të pranishmit falën bashkërisht namazin e akshamit, i cili përfundoi me salavate, dhikër, lutje, etj.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë do të vijojë edhe për disa xhami të tjera të Shkodrës.



“NËN DRITËN E KUR’ANIT” EMISION I VEÇANTË ME RASTIN E RAMAZANIT 1444/2023

Myftinia Shkodër për gjatë muajit të begatë të Ramazanit organizoi emisionin “Nën Dritën e Kur’anit”, me rreth 17 pjesë të ndryshme si: bashkëbisedime, intervista dhe hytbe, ku përmes tyre imamë, teologë dhe teologe dhanë mesazhe dhe këshilla të dobishme.

Ky emision, që u drejtua nga teologu Arben Halluni, u publiku në rrjetet sociale të Myftinisë Shkodër si në facebook, youtube, por u transmetuan nën drejtimin e Myftinisë edhe në programin e përvitshëm televiziv “Ramazani midis nesh” në Tv1 Channel si dhe në emisionin radiofonik “Jehonë Ramazani”, në Radio Jehona.

Gjatë këtij cikli bashkëbisedimesh fetare, u trajtuan tema me dobi, si:

1. Udhëzimet dhe Mesazhet e Ramazanit, nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed Sytari
2. Agjërimi, edukimi i tij dhe disa rregulla, nga H. Naim Drijaj
3. Dispozitat e agjërit, nga H. Ervil Kuçi

4. Dua-lutja dhe pozita e saj, kryesisht në Ramazan, nga H. Lavdrim Hamja

5. Komentimi i tre ajeteve të para të Sures EL-Muzemmil, nga H. Idmir Plaku

6. Komentimi i ajeteve 155, 156 dhe 157 të sures EL-Bekare, nga H. Adem Pizga

7. Komentimi i ajetit 53 i sures Ez-Zumer/Ajeti më shprehëdhënës në Kur’an, nga H. Durim Kasemi

8. Falënderimi në Ramazan, nga H. Gilman Kazazi

9. Komenti dhe mesazhi i sures EL-Kadër, Nata e Kadrit, nga H. Besim Barbullushi

10. Koment i ajeteve 29 dhe 30 të sures Fatir, nga teologe Jetmira Plaku (Kakini)

11. Komentim i ajeteve 33, 34, 35 të sures Fussilet/Thirrja në Islam, nga teologe Zamira Bushati



12. Në mes të lamtumirës së Ramazanit dhe në prag të Fitër Bajramit, nga teologe Ferzet Ndoja.

Ligjërata e tyre sollën interes për teleshikuesit dhe ndjekësit e tyre në kanalën zyrtar në youtube, por jo vetëm.

Myftinia Shkodër, nëpërmjet këtyre mesazheve me vlerë, ishte më pranë besimtarëve, duke përcjellë në këtë mënyrë mësim të dobishme që na duhen në përditshmërinë tonë.

Këto emisione janë të disponueshme në çdo kohë në profilin zyrtar të Myftinisë Shkodër, në facebook dhe youtube: Myftiniashkodër1990.

MYFTINIA SHKODËR VAZHDON SHPËRNDARJEN E PAKOVE TË RAMAZANIT PËR SHITESAT NË NEVOJË

Ditën e mërkurë paradite, më 12 prill 2023, Myftinia Shkodër ka vijuar organizimin e veprimtarisë së shpërndarjes së pakove të Ramazanit për shtresat në nevojë.

Falë bashkëpunimit me Shoqatën Humanitare “Jetimët e Ballkanit”, sot janë shpërndarë 200 pako me ushqime dhe detergjente, për anëtarët e Shoqatës së të Verbërve Shkodër, familjeve të lagja e Urës së Bunës dhe në fshatin Omaraj, Postribë.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni në prani të medieve tha se: “Myftinia Shkodër

në kuadër të muajit të begatë të Ramazanit vazhdon shpërndarjen e ndihmave për shtresat në nevojë, të varfër dhe skamnor, të cilët zënë një hapësirë të veçantë gjatë këtij muaji të agjërit, si dhe në shenjë humanizimi dhe solidariteti me ta”.

Teologu Halluni u bëri thirrje edhe institucioneve të tjera humanitare, shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit që të kontribuojnë dhe të ndihmojnë shtresat e ndryshme në nevojë, të cilat realisht dhe fatkeqësisht po shtohen dita-ditës.

Myftinia Shkodër do të vazhdojë



edhe në ditët e tjera të muajit të Ramazanit, me shpërndarjen e ndihmave të ndryshme të familjet në nevojë, jetimët, etj.



FITËR BAJRAMI, DITË E MADHE E ADHURIMIT DHE VËLLAZËRISË ISLAME

Që në orët e para të sabahut të ditës së xhuma, më 21 prill 2023, xhamitë e Shkodrës, në qytet dhe fshat, u tejmbushën me besimtarë, duke u bërë dëshmitarë të një ripërtëritjeje të mrekullueshme të fetarizmit dhe lidhjes me xhaminë në Shkodër.

Myftiu dhe imamët, dhanë mesazhe të lidhen me të sotmen, besimin, afrimin me vlerat e Islamit dhe gjallërimin e marrëdhënies me Kur'anin Famëlartë në përditshmërinë tonë.

Në vasin e tij, në xhaminë e Parrucës, Imam Muhamed B. Sytari, Myftiu i Zonës Shkodër, bëri thirrje për t'u distancuar nga zullumet, vrasjet, droga dhe veset, që duan t'i marrin frymën vendit.

Myftiu vuri theksin edhe te rëndësia e lidhjes me



XHAMIA PARRUCË



XHAMIA PARRUCË

trashëgiminë e vjetër islame, falë së cilës në trojet shqiptare dominon fryma e harmonisë dhe tolerancës ndërfetare, për të cilën tha se duhet ta dëshmojmë si një mrekulli prej mrekullive të shenjtërisë së fesë islame dhe burimeve të saj të pastra e të pandryshueshme.

Ai foli edhe për atmosferën e mrekullueshme të Muajit Ramazan dhe u lut për qytetin e Shkodrës, Shqipërinë dhe mbarë njerëzimin, që të kenë dritë, udhëzim dhe paqe.

Në momentin e faljes së Fitër Bajramit, Myftiu shprehu zhgënjimin e tij për mospraninë në xhami të deputetëve dhe kandidatëve për kryetar të Bashkisë Shkodër.



XHAMIA BARBULLUSH



XHAMIA SHIROQ



XHAMIA E "DY VAJZAVE"



XHAMIA BARDHAJ

ATMOSFERË FESTIVE E FITËR BAJRAMIT NË DISA MEJTEPE TË XHAMIVE TË SHKODRËS

Ditën e xhuma, më 21 prill 2023, Myftinia Shkodër përmes sektorit të arsimit organizoi disa vizita për festën e Fitër Bajramit në disa mejtepe fetare, konkretisht në xhamitë: Ura e Bunës, Zues, Oblikë, Barbullush dhe Bardhaj.

Drejtpuesi i arsimit, teologu Arben

Halluni gjatë këtyre vizitave përcolli urimin e tij për festën e madhe të Fitër Bajramit, si ditë e veçantë hareje, gëzimi, paqeje dhe lumturie. Ai u lut për suksesin e tyre në jetë, për mirësi dhe begati në familjet e tyre dhe kudo.

Gjatë këtyre vizitave teologu Halluni shpërndau për nxënësit e xhamive të

lartpërmendura rreth 40 torta si shenjë gëzimi, si dhe për të qenë më afër njërë-tjetrit në këto ditë atmosferë festive.

Myftinia Shkodër falënderon pastiçeri "Alivoda", që me rastin e festës së Fitër Bajramit dhuroi këto ëmbëlsira për nxënësit e xhamive tona.



XHAMIA ZUES



XHAMIA OBLIKË




XHAMIA BARBULLUSH



XHAMIA BARDHAJ



XHAMIA URA E BUNËS



Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org